



Pranuar / Dorezuar Punijena/Prudato Received/Delivered	15-03-2022	2	vite god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prisje Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUPSHICK	1399/2022		1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.94/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.94/2022, të datës 04.02.2022, të parashtruar nga ankuesja [redacted] Departamenti Prodhimit të Dokumenteve Prishtinë, kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen administrative-juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datë 15.03.2022, unanimisht mori këtë:

**V E N D I M**

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.94/2022 e datës 04.02.2021, e parashtruar nga ankuesja [redacted]

**A r s y e t i m**

Ankuesja [redacted] "Operatore në arkiv" në Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve në Agjencinë për Regjistrim Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, më datë 04.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 530/2022 të regjistruar me numër A.nr. 94/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos përgjigjes së organit kompetent për kompensimin e shpenzimeve në rastin e vdekjes së anëtarit të familjes.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 15.02.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses tek Ministria e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datë 01.03.2022 ka pranuar përgjigjen në kërkesë me numër protokoll 1073/2022 së bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.94/2022 të datës 04.02.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim civil të Kosovës; Kërkesë për kompensim për anëtarin e ngushtë të familjes së nëpunësit civil i datës 11.01.2022; Certifikatë e lindjes me numër L24451046 i datës 06.01.2022; Certifikatë e vdekjes me numër V10470091 i datës 06.01.2022; Deklaratë për bashkësinë familjare me numër F11175419 i datës 05.01.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 15.02.2022; Përgjigje në ankesë e datës 01.03.2022; Akt Emërimi i datës 04.04.2013; E-mail i datës 03.03.2022;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për pranueshmërinë e ankesës dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses [redacted] është e pa bazuar, sepse:

Bazuar në shkresat e lëndës, gjegjësisht sipas Akt Emërimit me Nr.Ref: DPD/ARC 64/2013 të datës 04.04.2013, Kolegji ka konstatuar se ankuesja [redacted] është e punësuar në pozitën e punës "Operatore në arkiv" në Departamentin për Prodhimin e Dokumenteve në Agjencinë për Regjistrim Civil në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Ankuesja me datë 11.01.2022 i është drejtuar u.d.Menaxheres së Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme me kërkesë për kompensim për anëtarin e ngushtë të familjes së nëpunësit civil, Zyra e Burimeve njerëzore e MPB-së përmes imellit zyrtar të datës 03.03.2022 ka njoftuar KPMSHCK se ankuesja është njoftuar për mes telefonit se kërkesa e saj për kompensim me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes nuk është procesuar për shkak të mungesës së bazës ligjore.

Ankuesja brenda afatit ligjor, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor kundër mos përgjigjes së organit kompetent për kompensimin e shpenzimeve në rastin e vdekjes së anëtarit të familjes. Propozon që Këshilli të njeh të drejtën e kompensimit të një shumë monetare në vlerën e një page mesatare me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes ose të detyrojë organin e punësimit që ti jap përgjigje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave lidhur me pretendimin ankimor të ankueses ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Nëpunësit civil, kanë të drejtat në vijim; 2.4 ndihma në rast të vdekjes së nëpunësit ose vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj dhe ndihmë familjes në rast të vdekjes së nëpunësit civil; si dhe dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 22, ku përcaktohet se: 2. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil, në rast të vdekjes së një anëtarit të ngushtë të familjes së tij/saj, institucioni ndihmon nëpunësin civil me një shumë monetare me vlerë prej një (1) page mesatare në Shërbimin Civil, dhe si rrjedhojë Kolegji konstaton se me rastin e vdekjes së anëtarit të ngushtë të familjes, nëpunësi civil gëzon të drejtën e ndihmës institucionale, përmes kompensimit të një shume monetare në vlerë të një (1) page mesatare në Shërbimin Civil.

Ndërsa lidhur me faktin se kush përbënë familjen, Kolegji për shqyrtimin e ankesave i është referuar dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen i Kosovës lidhur me përkufizimin e bashkësisë familjare, ku në nenin 271 përcaktohet se: Bashkësia familjare përfshin bashkëshortët dhe familjen e tyre të ngushtë, që në këtë Ligj përfshijnë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Personat tjerë të afërm të familjes

si dhe personat të cilët kryesisht janë të varur ekonomikisht dhe të cilët jetojnë në shtëpi të përbashkët me bashkëshortët, mund të konsiderohen anëtarë të bashkësisë familjare për qëllimet e këtij ligji. Çështja e përkufizimit të familjes sipas dispozitave të Ligjit Nr.2004/32 për Familjen e Kosovës, për qëllim të kompensimit të nëpunësve civil me rastin e vdekjes së anëtarit të familjes, është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit të Kosovës, në Aktgjykimin A.A.nr.14/2017.

Andaj, bazuar në shkresat e lëndës respektivisht certifikatat e gjendjes civile, Kolegji ka konstatuar se e ndjera [redacted] ka qenë motër e ankueses, ndërsa ankuesja ka statusin e martuar dhe pasi që në shkresat e lëndës nuk ka dëshmi se ankuesja ka qenë duke jetuar në bashkësi familjare me të ndjerën apo ka ndarë ekonomi të përbashkët me të, Kolegji vlerëson së pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin e një shume monetare në vlerë të një page mesatare në Shërbim Civil, është i pa bazuar.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.94/2022.**

Çlirim Zeka



Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Agjencinë për Regjistrim Civil ;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

